

VENDIM
Nr. 43, datë 15.3.2019

MBI MIRATIM E “PROPOZIMIT TË TË GJITHA OST-ve PËR NJË METODOLOGJI TË OFRIMIT TË DHËNAVE TË GJENERIMIT DHE NGARKESËS NË PËRPTHJE ME NENIN 16 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2015/1222 TË DATËS 24 KORRIK 2015 PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E KAPACITETEVE DHE MENAXHIMIN E KONGJESTIONEVE”

Në mbështetje të neneve 16, 7, 56 dhe 63 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”.

konstatoi se:

- OST sh.a. me shkresën nr. 8383 prot., datë 11.12.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimin e të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”.

- Me vendimin nr. 2, datë 17.1.2019, Bordi i ERE-s është shprehur për fillimin e procedurës për miratim të “propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të rregullores së komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, ERE, me shkresën 32/3 prot., datë 14.2.2019, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure; me shkresën nr. 35/9 prot., datë 29.1.2019, ka njoftuar këtë vendim pranë QBZ-së; me shkresat nr. 171 prot. dhe nr. 173 prot; datë 20.2.2019 ka bërë me dije dhe ka kërkuar opinion nga palët e interesit.

- Rezulton se mbas përfundimit të afateve të pritjes së komenteve dhe opinioneve nuk ka komente apo sugjerime në lidhje me këtë akt.

- Dokumenti vjen në vijim të komunikimit nr. 3886 prot., datë 25.5.2018, me objekt “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë” dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë së Modelit të Përbashkët të Rrjetit.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, me ligjin 8/2018, përkatësisht neni 56 dhe neni 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 117 “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij, sipas dokumentit bashkëngjitur është dërguar për miratim “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”, të përshtatur në shqip nga OST sh.a., në përputhje me

nenin 19 të dokumentit origjinal.

- Dokumenti i përbërë nga 19 nene saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës të nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel evropian analiza e sigurisë me qëllim alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionëve.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do tia përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet jo-anëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen gjithashtu që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionëve”.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi